



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1995 Prot.

Tiranë, më datë 06.10.2023

VENDIM
Nr. 528, datë 06.10.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknikë dhe Sportelit Unik të Safj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 06.10.2023:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit “*Centralet prodhuese të energjisë HEC 2ER*”, me aplikues Skënder Muçaj dhe zhvillues **BREÇANI - R.O.S.P. sh.p.k.**;
2. Subjekti zhvillues të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;
3. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve për projektin “*Centralet prodhuese të energjisë HEC 2ER*”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislationit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
4. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje rastësore siç parashikon dhe legjislationi për trashëgiminë kulturore, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohen pranë IKTK-së, sipas Ligjit Nr. 27, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, datë 17.05.2018, neni 145 - 147;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknikë për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

KRYETAR
Elva MARGARITI

